



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJË**

Nr. 3112 / Prot.
2

Tiranë, më 57 .2023

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1740, datë 10.02.2015.

SHOQËRISË “GRUPPO BABASI” SH.P.K

Budull, Ndërtese private, 2 katëshe, Bubq, Durrës.

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “GRUPPO BABASI” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1740, datë 10.02.2015, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në objektin “Baks, Postribë”, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër.

Me anë të shkresës Nr. 3112, datë 29.03.2023, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, subjekti “GRUPPO BABASI” sh.p.k ka kërkuar revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1740, datë 10.02.2015, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në objektin “Baks, Postribë”, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër, pasi aktiviteti minerar ka krijuar problematika me banorët e zones përreth.

Propozimi është i mbështetur në Nenin 47, pika 2, gërma “a” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1740, datë 10.02.2015, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në objektin “Baks, Postribë”, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër, që shoqëria Juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Nr.1740, datë 10.02.2015, për mineralin gëlqeror i mermerizuar, në objektin “Baks, Postribë”, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Referuar pikës 2 dhe 3, të nenit 37 “Detyrimi i rehabilitimit të zonës së lejes minerare”, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i

ndryshuar, shoqëria tuaj, si zotëruese e lejes minerare ka detyrimin që, gjatë veprimtarisë minerare dhe në përfundim të saj, të zbatojë planin e veprimtarive të mbylljes së objektit mineral, planin e rehabilitimit të mjedisit të zonës minerare dhe planin e menaxhimit të mbetjeve minerare, miratuar nga struktura përgjegjëse, së bashku me lejen minerare, si pjesë të kësaj lejeje. Rehabilitimi i zonës së lejuar minerare kryhet nga vetë zotëruesi i lejes apo nga subjektet e kontraktuara nga ai dhe nën përgjegjësinë e zotëruesit, në mënyrë progresive dhe brenda afateve kohore të përcaktuara, sipas planit të veprimtarive të mbylljes së minierës e atij të rehabilitimit të mjedisit.

Në zbatim të pikës 7, të nenit 37 “Detyrimi i rehabilitimit të zonës së lejes minerare”, mosrealizimi i planit të rehabilitimit nga zotëruesi i lejes i heq të drejtën atij të përfitojë leje për një veprimtari tjetër minerare, për një periudhë 50-vjeçare, që llogaritet nga fundi i afatit të vlefshmërisë së lejes së parë dhe përbën shkak për revokimin e çdo lejeje tjetër të vlefshme të të njëjtit zotërues, të dhënë sipas këtij ligji.

Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të hartohet dhe të dërgohet për shqyrtim në AKBN, “Raporti tekniko-ekonomik dhe plani i rehabilitimit të mjedisit, plani i trajtimit të mbetjeve dhe plani i mbylljes përfundimtare”, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të shoqërisë tuaj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

